**Tabelë e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të drejtorëve/ive, arsimit, kualifikimet e drejtuesve**

| Drejtoria/Struktura | Detyrat funksionale | Arsimi dhe kualifikimet e drejtuesve/CV |
|---|---|---|
| **Këshilli Drejtues** | KD është organi më i lartë drejtues i AKEP-it, i zgjedhur nga Kuvendi Republikës së Shqipërisë.<br><br>KD, ushtron veprimtarinë e tij vendimmarrëse në mënyrë kolegjiale dhe të pavarur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918 për komunikimet elektronike dhe postare dhe ligjit 46/2015 për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë. | Rreth Akep – AKEP |
| **Kabineti Kryetarit:**<br>Drejtor Kabineti<br>Këshilltar | Për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave Kryetari ndihmohet/asistohet nga funksionarët ndihmës në përbërje të Kabinetit. | Sara Xhumbari |
| **Drejtoria Juridike dhe Integrimit**<br><br>1. Drejtor<br>**Sektori i Shërbimeve Ligjore**<br><br>2. Përgjegjës sektori<br>3. Specialist<br>4. Specialist<br>**Sektori i Çështjeve Gjyqësore**<br><br>5. Përgjegjës sektori<br>6. Specialist<br>7. Specialist<br>**Sektori i Integrimit dhe Marrëdhënieve Publike:**<br><br>8. Përgjegjës sektori<br>9. Specialist<br>10. Specialist | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë Juridike dhe Integrimit është kryerja e detyrave për sigurimin e mbështetjes në aspektin ligjor të veprimtarisë së AKEP–it gjatë ushtrimit të kompetencave dhe funksioneve rregullatore dhe administrative të AKEP-it.<br><br>Drejtoria Juridike dhe Integrimit ka për objekt të punës zbatimin e politikave strategjike kombëtare për integrimin europian sipas legjislacionit në të cilën përfshihet veprimtaria e AKEP, si dhe ndjekjen e marrëdhënieve me publikun dhe jashtë. | Jonida Gjika<br><br>(CV) |
| **Drejtoria Teknike**<br><br>1. Drejtor<br>**Sektori i Administrimit dhe Koordinimit të SRF:**<br>2. Përgjegjës sektori<br>3. Specialist<br>4. Specialist<br>**Sektori i Numeracionit, Sigurisë së Rrjeteve, Infrastrukturës dhe IT:**<br>5. Përgjegjës sektori<br>6. Specialist<br>7. Specialist<br>8. Specialist<br>9. Specialist | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë Teknike është kryerja e detyrave që lidhen me zbatimin e detyrimeve dhe ushtrimin e kompetencave ligjore të AKEP-it në drejtim të administrimit të spektrit të frekuencave, numeracionit, sigurisë së rrjeteve, administrimit të Sistemit të Përqëndruar të Informacionit mbi infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike, faciliteteve shoqëruese, shërbimeve broadband dhe të drejtës së kalimit. | |

| | | |
|---|---|---|
| **Drejtoria e Autorizimeve**<br><br>1. Drejtor<br><br>**Sektori i Autorizimeve:**<br><br>2. Përgjegjës sektori<br>3. Specialist<br>4. Specialist<br><br>**Sektori i Administrimit Domain.al dhe Konformitetit të Pajisjeve**<br><br>5. Specialist<br>6. Specialist | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Autorizimeve është kryerja e detyrave që lidhen me zbatimin e detyrimeve dhe ushtrimin e kompetencave ligjore të AKEP-it lidhur me regjistrimin e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm, lëshimin e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave, dhënien e autorizimeve sipas ligjit nr.46/2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, njohjen e konformitetit për pajisjet “radio” dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve, administrimin e domain cc.TLD.al, nëndomainet e tij. | Jetmir Braha<br>(CV) |
| **Drejtoria e Monitorimit, Kontrollit dhe Inspektimeve**<br><br>1. Drejtor<br><br>**Sektori i Administrimit të Qendres Kombëtare dhe Zyrave: Rajonale të Monitorimit të SRF**<br><br>2. Përgjegjës sektori<br>3. Specialistë (monitorues)<br>4. Specialistë (monitorues)<br>5. Specialistë (monitorues) **Shkoder**<br><br>6. Specialistë (monitorues) **Kruje**<br>**7.** Specialistë (monitorues) **Vlore**<br>8. specialistë (monitorues) **Korce**<br><br>**Sektori i Kontrollit dhe Inspektimit:**<br>9. Përgjegjës sektori<br>10. Inspektorë Tirane<br>11. Inspektorë Tirane<br>12. Inspektorë **Shkoder**<br>13. Inspektorë **Kruje**<br>14. Inspektorë **Vlore**<br>15. Inspektorë **Korce** | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Monitorimeve, Kontrollit dhe Inspektimeve është kryerja e detyrave që lidhen me zbatimin e detyrimeve dhe ushtrimine kompetencave ligjore të AKEP-it për monitorimin e spektrit të frekuencave, zbatueshmërinë e standardeve dhe cilësisë të rrjeteve dhe ofrimit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, si dhe inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publikë dhe të shërbimit postar ose çdo personi tjeter fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe atë të shërbimit postar. | |

| | | |
|---|---|---|
| **Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore**<br>1. Drejtor<br><br>**Sektori i Kërkimeve, Analizës, Tarifave dhe Statistikave:**<br>2. Përgjegjës sektori<br>3. Specialist<br>4. Specialist<br>5. Specialist<br><br>**Sektori i interkoneksionit dhe aksesit:**<br>6. Përgjegjegjës sektori<br>7. Specialist<br>8. Specialist | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore është kryerja e detyrave që lidhen me zbatimin e detyrimeve dhe ushtrimin e kompetencave të AKEP-it të parashikuara në legjislacionin e fushës për rregullimin e konkurrencës dhe sigurimin e shërbimit universal në tregun e komunikimeve elektronike dhe atë postare me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore të përcaktuara në Ligjin 9918. | Gazmir Mani<br>(CV) |
| **Drejtoria e të Drejtave të Përdoruesve**<br>1. Drejtor<br><br>**Sektori i Mbrojtjes së të Drejtave të Përdoruesve dhe Portabilitetit**<br>2. përgjegjës sektori<br>3. specialist<br>4. specialist<br><br>**Sektori i Shërbimit Universal:**<br>5. specialist<br>6. specialist | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së të Drejtave të Përdoruesve, është kryerja e detyrave në lidhje me të drejtat e përdoruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike si dhe të shërbimeve postare, brenda kompetencës dhe juridiksionit ligjor të AKEP si organ rregullator i fushës. | Altin Rrapaj<br>(CV) |
| **Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar**<br>1. Drejtor<br><br>**Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar:**<br>2. Përgjegjës sektori<br>3. Specialist<br>4. Specialist<br><br>**Sektori i Pagesave, Monitorimit dhe Zbatimit të Kontratave**<br>5. Përgjegjës sektori<br>6. Specialist<br>7. Specialist | Objekti i veprimtarise së Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar është kryerja e detyrave për sigurimin e mbështetjes në aspektin financiar të veprimtarisë së AKEP-it gjatë ushtrimit të kompetencave dhe funksioneve rregullatore, si dhe menaxhimit dhe administrimit financiar të institucionit. | Etleva Alushi<br>(CV) |

| | | |
|---|---|---|
| **Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme**<br><br>1. Drejtor<br><br>**Sektori i Burimeve Njerëzore:**<br>2. Përgjegjës sektori<br>3. Specialist<br>4. Specialist<br><br>**Sektori i Protokollit dhe Arkivës:**<br>5. Specialist<br>6. Specialist<br><br>**Sektori i Shërbimeve Mbështetëse:**<br>7. Përgjegjës sektori<br>8. Punonjës informacion dhe magazinjer<br>9. Punonjës mirëmbajtje<br>Shofer 4<br>Pastrues 2 | Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme është sigurimi i organizimit, drejtimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, shërbimeve mbështetëse sipas legjislacionit në fuqi me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore dhe administrimin sa më profesional dhe efiçent të kapaciteve njerëzore. | Jonida Koçi<br><br>(CV) |